7.2	Furnizimi me material si dhe montimi i ulseve pran pemes, pozicioni përfshinë konstruksionin mbajtës prej qeliku , ulset prej druri si dhe mbështetje prej druri. Në çmim duhet të parashihet ankerimi në murin beton arme sipas detalit. si dhe lyerja me material për mbrojtje kundër lagështisë, insekteve, këpurdhave si dhe lyerje përfundimtare. Ulsja është për tre persona, punëkryesi obligohet që para vurjes në veper të marr aprovimin nga ana e organit mbikëqyrës si dhe gjithashtu paraprakisht të presentoj certifikatat dhe atestet e nevojshme për aprovim nga ana e organit mbikëqyrës. Lloji i ulseve duhet të jet i patentuar dhe certifikuar.	copë	1.00	175.00	175.00 €
7.3	Furnizimi me material si dhe montimi i shportes se berlogut me dimensione te jashtme 37/37 cm dhe lartesi H= 68 cm me kapacitet 50 litërsh. Në çmim duhet të parashihet ankerimi në dyshe me si dhe lyerja me material për mbrojtje kundër lagështisë, insekteve, këpurdhave si dhe lyerje përfundimtare. Shporta është me mekanizem per hjekjen e berlogut, punëkryesi obligohet që para vurjes në veper të marr aprovimin nga ana e organit mbikëqyrës si dhe gjithashtu paraprakisht të presentoj certifikatat dhe atestet e nevojshme për aprovim nga ana e organit mbikëqyrës. Lloji i Shportes duhet të jet i patentuar dhe certifikuar.	copë	5.00	35.00	175.00 €
		Gjithsej: Pos B7			665.00 €
B8	PUNIMI I GJELBRIMIT				
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
8.1	Furnizimi, transporti, hapja e gropave dhe mbjellja e fidanëve me fletë shumëngjyrshë (Acer Rubrum), lartësia e drurit nga toka deri në degëzimet e para të jenë 2 mm me kurorë të formuar deri në 2.30-2.50 m lartësi. Trashësia e trungut nga toka e deri në 1.0 m lartësi të jetë me perimeter 16-18 cm. Druri duhet të jetë i kultivuar në vazo me dhe të mirë humusor dhe të ketë sistëm rrënjorë mire të zhvilluar. Fidanet duhet të jenë të zhvilluara në vazo me madhësi prej 80 litra. Furnizuesi për fidanet duhet të dëshmojë me certificate fitosanitare dhe të ketë dëshmi për prejardhjen e tyre nga vendet e BE- së.	copë	1.00	100.00	100.00 €
8.2	Furnizimi transporti dhe mbjellja e fidaneve të shkurreve të llojit Buxus sempervirens, sipas projektit të mbjelljen në zonën mbrojtëse të parkut të lojrave. Në çmim të parashihet edhe mbjellja.	copë	40.00	5.00	200.00 €
8.3	Kontrolli dhe mbrojtja e fidave të mbjellura ndaj semundjeve të ndryshme , larvave dhe parazitëve të ndryshëm, si dhe dizinfektimi , Dezinsektimi i tyre , sipas nevojave dhe kërkesave të Menaxherit Projektit	copë	41.00	2.00	82.00 €
8.4	Furnizimi, transporti , mbjellja dhe mirëmbajtja e gjelbërimit- barit italian deri në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e duhur për zhvillim me dendësi 30-40 gr/m² ose sipas udhëzimit të prodhuesit si dhe furnizimin dhe mbulimin me një shtresë të imet dheu pas mbjelljes, rrafshimin me ngjeshje me cilindër të dorës/kopshtarit prej 50-60 kg.	m2	55.00	3.00	165.00 €
		Gjithsej: Pos B8			547.00 €
B. REKAPITULIMI - RREGULLIMI I PJESËS SË JASHTME TË STACIONIT					
B1	PUNIMET TOKËSORE	Gjithsej: Pos B1		1,603.50 €	
B2	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)	Gjithsej: Pos B2		5,488.00 €	
B3	PUNIMET E MBISTRUKTURËS SE PLATFOMES SE KEMBESOREVE DHE ASFALTIT	Gjithsej: Pos B3		14,155.00 €	
B4	PUNIMET E BETONIT	Gjithsej: Pos B4 (a+b)		4,841.00 €	
B5	PUNIMET E ARMATURES	Gjithsej: Pos B5		952.00 €	

B6	PUNIMET E RRETHOJËS METALIKE	Gjithsej: Pos B6	2,400.00 €
B7	MOBILARI URBAN	Gjithsej: Pos B7	665.00 €
B8	PUNIMI I GJELBRIMIT	Gjithsej: Pos B8	547.00 €
TOTALI ME TVSH			30,651.50 €

D. PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE ATMOSFERIK NË PLLATO E STACIONIT AUTOBUSAVE

D1	PUNËT E DHEUT, ZHAVORRIT DHE RËRËS				
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
1.3	Prerja vijore e asfaltit, betonit dhe materialeve tjera të ngurta për krijimin e hapsires për vendosjen e gypit të kolektorit të ujërave Atmosferike .	m'	250	1.00 €	250.00 €
1.4	Demolimi i gypave egzistues të kanalizimit dhe gypave tjerë egzistues dhe transporti deri në deponi.	m'	250	0.50 €	125.00 €
1.5	Demolimi i pusetave të ndryshme egzistuese me thellsi nga H=1.5-3.5m komplet në gjatësinë e rrugës e cila do të rikonstruktohet dhe largimi deri në deponi. Llog komplet me të gjitha shpenzimet	komplet	1	130.00 €	130.00 €
1.6	Demolimi i ujëmbledhsave egzistuese duke përfshirë puseten dhe gypat lidhës komplet në gjatësinë e rrugës e cila do të rikonstruktohet dhe largimi deri në deponi. Llog komplet me të gjitha shpenzimet	komplet	1	50.00 €	50.00 €
1.7	Realizimi i lidhjes së gypit të projektuar në kolektorin shkarkues duke përfshirë hapjen e vrimes mbylljen dhe të gjitha pozicionet e nevojshme për një funksionim të plotë.	m'	250	0.50 €	125.00 €
1.8	Gërmimi me dorë , makina , dhe Çekan dhe transporti deri në deponi i dheut , me ngarkim dhe shkarkim në vendin ku e cakto organi mbikqyrës, dheu është i kateg. së III-të IV , V dhe VI-të. Tëhet e kanaleve duhet të gërmohet në formë të rregullt dhe të përpunohet fundi i kanalit. Dheu i mihur duhet të menjahet larg kanalit në largësi min. 1.00 m - Gërmimi me makina në thellësinë mesatare të kanalit deri në 2.7m' , kurse gjërësia varet nga profili (Ø) i gypit, në çmim duhet llogaritur edhe mbrojtja e kanalit nga shembja				
A	gërmimi me makinë 60%	m³	375	1.00 €	375.00 €
B	gërmimi me dorë 20%	m³	125	1.00 €	125.00 €
C	gërmimi me Çekan 20%	m³	125	1.00 €	125.00 €
1.9	Mbrojtja e gropës ndërtimore në tërë gjatësinë e kanalit.	m'	250	0.20 €	50.00 €
1.10	Zgjerimi dhe thellimi në vendet e pusetave. Zgjerimi bëhet për nga 50 cm dhe thellimi për 40 cm, në dy metër gjatësi kol. 7 puseta	m³	20	2.00 €	40.00 €
1.11	Planifikimi i fundit të kanalit pas përfundimit të gërmimit duke dhënë ramjen e saktë sipas projektit. Llogaritja bëhet për 1 m2 të sipërfaqes reale të planifikuar.	m²	250	0.20 €	50.00 €
1.12	Furnizimi, shtrirja dhe mbulimi i gypave me shtresë rëre dhe zhavori d=0-4mm me trashësi t=(10+15)cm, sipas detajit në projekt.	m³	62.5	3.00 €	187.50 €
1.13	Furnizimi, transporti dhe vendosja e shiritit sinjalizues mbi shtresën e zhavorit standart për rrjeta të kanalizimit atmosferik.	m'	250	0.05 €	12.50 €

1.14	Mbushja dhe mbulimi i kanalit me material nga guri gelqeror tampon 0-60mm duke e ngjeshur në shtresa max 20-30 cm me Mv>90Mn/m2.	m³	500	1.50 €	750.00 €
1.15	Largimi i ujit nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit të kanalit.	ore	5	3.00 €	15.00 €
Gjithsej: Pos D1					2,410.00 €
D2	PUNËT E BETONIT DHE BETON ARMËS				
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
2.1	Përpunimi i fundit të pusëtës kontrolluese me C-20/25 (për punimin e pllakes nga betoni dhe kinetave) . Trashësia (lartësia) mesatare e fundit është 30cm. Këto funde shërbejnë si bazë për vendosjen e unazave të gatshme montuese nga betoni Ø800 mm, kurse diamaterin e kanë 1.100 mm.	m³	1.73	40.00 €	69.12 €
2.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për puseten e ujmbledhësave nga beton armeja C 25/30 me dim:40*40cm sipas detalit teknik ne projekt.	copë	4	25.00 €	100.00 €
2.3	Furnizimi dhe ndërtimi i unazave montuese të betonit armuar me shpuarjen e hapsirave për vendosjen e gypave të kanalizimit, lidhja e gypave me llaq çimentoje. Për secilën pusetë është e nevojshme të furnizohen unazat e prerjes konstante Ø800 mm dhe nga një unazë në formë të konit (Ø800mm në Ø700 mm) në pjesën e ngushtë të të cilit montohet korniza me kapakun e rëndë, shkurtohet sipas nevojës në varshmëri të ndryshimit të lartësisë së pusëtës. Është e nevojshme të furnizohen unaza në formë të konit dhe me formë konstante:				
2.4	a) unaza në formë të konit	copë	8	30.00 €	240.00 €
2.5	b) me profil konstant	m'	20	15.00 €	300.00 €
Gjithsej: Pos D2					709.12 €
D3	PUNËT E METALPUNUESE				
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
3.1	Furnizimi transporti montimi dhe betonimi i kapakëve prej gize, për pesha të rënda. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-25/30.	copë	4	55.00 €	220.00 €
3.2	Shkallët në puseta Furnizimi, transporti dhe ndërtim montimi i shkallëve të hekurta Ø 20 mm në murin e pusëtës. Shkallat të vendndërtohen në çdo 30 cm me ngjyrosje kundër korozionit. Logaritja me copë.	copë	4	15.00 €	60.00 €
3.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i grilave të pusetave për ujëbledhësat (prej gize), për pesha të rënda. Në çmim të llogarohet: betonimi i kurorës prej beton armesë C-25/30.	copë	4	35.00 €	140.00 €
Gjithsej: Pos D3					420.00 €

D4	PUNËT MONTUESE				
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
4.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e të gjitha pozicioneve të nevojshme për realizimin e kyqjeve nga objektet egzistuese në puseten e ndërtuar duke përfshirë : germim mbulimin me zhavor dhe gypin F160mm (gjatësia e lidhjes nga 5-10m).	copë	2	50.00 €	100.00 €
4.2	Furnizimi, transporti dhe realizimi i lidhjes së ujëmbledhsave me puseten e kolektorit kryesorë duke përfshirë hapjen e vrimes me shpim horizontal, perforcimin e gypit me beton armës 15 cm në pjesën e poshtme dhe sipërme sipas detalit teknike në projekt , në qmim përfshihet edhe vendosja e gypit HDPE F160mm me të gjitha shpenzimet	m'	100	3.00 €	300.00 €
4.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 për kolektorë Pagesa bëhet për 1 m' të gypit të montuar komplet duke përfshirë edhe evakuimin e ujërave të kanalizimit nga rruga Imer Berisha deri në lumë me gjatësi 200m'				
4.3.1	për kolektorë HDPE PSN8 DN- 315 mm	m'	250	3.00 €	750.00 €
4.4	Ngritja e pusetave ekzistuese , nivelizimi me nivelin e asfaltit /apo trotuarit , Në çmimi llogariten të gjitha punët beton muntuses të kokës së pusetës të përforcuar me armaturës, si dhe furnizimi transporti dhe vendosja e kornizës dhe kapakut të gizës me peshë rezistuese deri 60T	copë	10	25.00 €	250.00 €
Gjithsej: Pos D4					1,400.00 €

D. REKAPITULIMI - RREGULLIMI I PJESËS SË JASHTME TË STACIONIT			
D1	PUNËT E DHEUT, ZHAVORRIT DHE RËRËS	Gjithsej: Pos D1	2,410.00 €
D2	PUNËT E BETONIT DHE BETON ARMËS	Gjithsej: Pos D2	709.12 €
D3	PUNËT E METALPUNUESE	Gjithsej: Pos D3	420.00 €
D4	PUNËT MONTUESE	Gjithsej: Pos D4	1,400.00 €
TOTALI ME TVSH			4,939.12 €

E. PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR INSTALIMEVE ELEKTRIKE NË PLLATO E STACIONIT AUTOBUSAVE					
E1	PUNËT NDËRTIMORE				
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
1.3	Punët përgaditore -përfundimtare duke përfshirë edhe organizimin e punës , bartjen e pajisjes dhe mekanizimit në teren . Në fund pastrimi I terenit nga mbeturinat e bëra gjatë punës.	m'	100.0	0.20 €	20.00 €
1.4	Mihja e kanalit mejtas rrugës me dimensione 0.7x1.0m për vendosjen e kabllave të rrjetit 0.4kv, kabllave rezervë dhe shiritit përtokëzues sipas detalit gjegjës	m3	70.0	1.50 €	105.00 €

1.5	Mihja e kanalit mejtas rrugës me dimensione 0.7x0.8m për vendosjen e kabllave të rrjetit 10(20)kv , kabllave të sistemeve telekomunikuese dhe gypave rezervë sipas detalit gjegjës	m3	56.0	1.50 €	84.00 €
1.6	Mihja e kanalit tërthorë rrugës nga pusata në pusetë me dimensione 0.6x0.8m për vendosjen e gypave rezervë për nevoja të tanishme apo të ardhshme elektrike	m3	48.0	2.00 €	96.00 €
1.7	Shtirja e rërës në trashësi (10+10)cm rreth kabllave dhe gypave	m3	20.0	4.00 €	80.00 €
1.8	Mbushja e kanaleve me dhe në shtresa duke ngjeshur atë në depon e qytetit	m3	21.0	1.00 €	21.00 €
1.9	Largimi i dheut të tepërt nga trotuari dhe bartja e tij deri në depon e qytetit	m3	21.0	2.00 €	42.00 €
1.10	Porosija, transporti dhe montimi i shiritit për vërejtje nga PVC me gjerësi 40cm dhe trashësi 0.25mm .Shiriti duhet të mbaj shënimin : Kujdes , rrezik nga tensioni lartë".	m'	100.0	0.20 €	20.00 €
1.11	Mihja e kanaleve me dimensione 0.40x0.6m për vendosjen e kabllave furnizuese për shtëpitë e lagjes përgjatë rrugës dhe në mbrendesi të lagjeve. Qmimi duhet të ipet si i tërë dhe duhet të mbuloj të gjitha shpenzimet shtesë në rast të paraqitjes së problemeve pronore gjatë kalimit të kanaleve neper disa prona.Ne qmim gjithashtu duhet të perfshihet hudhja e reres, vendosja e shiritit, ngjeshja e dheut ne shtresa dhe largimi i dheut te tepert.	komplet	1.0	60.00 €	60.00 €
1.12	Ndertimi i pusetave të kabllave me beton të armiruar me dimesione të jashtme (100x200x200)cmme trashësi të mureve 15cm , sipas detalit të projektit. Qmimi ipet komplet me tërë materialin :Beton ,armaturë , drrasa për latim dhe material tjetër i imët.	copë	1.0	200.00 €	200.00 €
1.14	Furnizimi me material dhe montimi i kapakëve rrethor nga giza e derdhur me peshë të lehtë dhe të shënuar ELEKTRIKË për puseta të kabllor me diametër 60 cm	copë	1.0	50.00 €	50.00 €
1.15	Punimi i bazamentit për përforcimin e tabelës së furnizimit të energjisë elektrike nga betoni tip MB20. Bazamenti ka këto dimensione : (120x60x60)cm. Në bazament duhet të vendosen bulonat për ankerimin e tabelës. Detali është dhënë në projekt. Qmimi ipet për komplet bazamentin.	copë	1.0	50.00 €	50.00 €
1.16	Punimi i bazamentit për përforcimin e tabelës së telekomunikimit nga betoni tip MB20. Bazamenti ka këto dimensione : (70x50x60)cm. Në bazament duhet të vendosen bulonat për ankerimin e tabelës. Detali është dhënë në projekt. Qmimi ipet për komplet bazamentin	copë	1.0	50.00 €	50.00 €
1.17	Punimi i bazamentit për përforcimin e tabelës së ndriçimit nga betoni i tipi MB-20. Bazamenti ka këto dimensione : (90x50x60)cm. Në bazament duhet të vendosen bulonat për ankerimin e tabelës detali është dhënë në projekt. Qmimi ipet për komplet bazamentin.	copë	1.0	70.00 €	70.00 €
Gjithsej: Pos E1					948.00

E2		PUNËT E INSTALIMEVE ELEKTRIKE			
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
2.1.1	Furnizimi dhe vendosja e shtyllave metalike të ndriçimit, me derë për hapje dhe trashësi të mureve konform standardeve për zonë të II-të të erës. Shtyllat e NP të jenë nga materiali ST 37 (S235 JR), të galvanizuara sipas standardit; EN ISO 1461, konike, njëtrajtësisht të punuara (pa saldim të pjesëve). Sk. 1	copë	6.0	100.00 €	600.00 €
2.1.2	Furnizimi dhe vendosja e lirave standarde me gjatësi të krahut; Lmax=2.5m, nga materiali ST 37 (S235 JR) të galvanizuara, rrethore ose këndore të një anshme	copë	12.0	30.00 €	360.00 €
2.1.3	Punimi i bazamentit për përforcimin e tabelës së ndriçimit nga betoni I tipi MB-20. Bazamenti ka këto dimensione : (90x50x60)cm. Në bazament duhet të vendosen bulonat për ankerimin e tabelës detali është dhënë në projekt. Qmimi ipet për komplet bazamentin.	copë	1.0	50.00 €	50.00 €
2.1.5	Blerja, Bartja ,kompletimi me material, vendosja dhe lidhja e tabelës së ndriçimit. Tabela ka dimensione (120x80x40)cm.Punohet nga llamarina me trashsi 2mm. Mbrohet me ngjyrë te plastifikuar. Ka mbrojtje mekanike IP65 dhe eshte e paraparë per montim te jashtem. Ne te vendoset materiali sipas skemes njëpolare dhe lidhja kryhet sipas skemes se lidhjeve qe eshte pjesë e ketij projekti. Ne çmim duhet te parashihet edhe materiali ndimes: Perqesit fleksibil, papuqet, klemet 50mm² per dalje etj...	copë	1.0	100.00 €	100.00 €
2.1.6	Blerja,bartja shtrirja dhe lidhja e kabllos NAYY 4X16mm2 nga shtylla në shtyll si dhe lidhja me tabelën ndriçimit.	m'	250.0	0.70 €	175.00 €
2.1.7	Blerja,bartja shtrirja dhe lidhja e kabllos NAYY 4X25mm2 nga shtylla në shtyll si dhe lidhja me tabelën ndriçimit.	m'	250.0	0.70 €	175.00 €
2.1.8	Porosija, transporti dhe montimi i shiritit të tokëzuesit për përtokëzim të llampave dhe shtyllave fundore me dim: Fe/Zn25x4mm	m'	250.0	0.80 €	200.00 €
2.1.9	Porosija , transporti, dhe montimi papuqeve Al/Cu16/Ø8 për kablla të ndriçimit	m'	250.0	0.20 €	50.00 €
2.1.11	Blerja, Bartja ,kompletimi me material, vendosja dhe lidhja e tabelave te furnizimit. Tabela ka dimensione (140x110x40)cm.Punohet nga llamarina me trashsi 2mm. Mbrohet me ngjyrë te plastifikuar. Ka mbrojtje mekanike IP65 dhe eshte e paraparë per montim te jashtem. Ne te vendoset materiali sipas skemes njëpolare per një hyrje dhe 10 dalje. Ne çmim duhet te parashihet edhe materiali ndimes: Perqesit fleksibil, papuqet, klemet 50mm² per dalje etj...	copë	1.0	150.00 €	150.00 €
2.1.12	Blerja ,bartja shtrirja dhe lidhja e kabllos së tensionit 10(20)kv tip XHP-A 1x120mm2 nga trafostacioni	m'	250.0	2.00 €	500.00 €
2.1.13	Blerja, bartja shtrirja dhe lidhja e kabllos se alominit per furnizim te tabelave shpermdarese TE.. Tip: NAYY(3x185+50)mm²	m'	250.0	0.80 €	200.00 €

2.1.14	Blerja, bartja shtrirja dhe vendosja e kokave kabllorike ne te dy anet e kabllor XHP.te dyja janë per montim te brendshem	komplet	1.0	50.00 €	50.00 €
2.1.15	Blerja, bartja shtrirja dhe lidhja e kabllor NAYY 4x16mm ² nga tabelat furnizuese TE.. deri te secila shtepi e lagjes. Ne kete çmim duhet te perfshihet pra edhe lidhja neper TKF(tabela te kabllor furnizuese -KPO) apo neper konzolla neper secilen shtepi. Ne çmim duhet te perfshihet gjithashtu edhe materiali shtesë dhe i paparashikuar qe mund te nevoitet gjatë kryerjes se ketyre punve. Blerja e konzollave apo e TKF-ve nuk eshte pjesë e ketij projekti.	m'	250.0	0.80 €	200.00 €
2.1.16	Blerja, Bartja ,kompletimi me material, vendosja dhe lidhja e tabelës së telekomunikimit. Tabela ka dimensione (90x60x30)cm.Punohet nga llamarina me trashsi 2mm. Mbrohet me ngjyrë te plastifikuar. Ka mbrojtje mekanike IP65 dhe eshte e parapare per montim te jashtem. Ne te vendoset materiali sipas tabelave ekzistuese. Gjatë lidhjeve te ketyre sistemeve duhe te mirret edhe mendimi i PTK-s dhe pronarve tjerë te rrjeteve telekomunikuese qe ndodhen ne afersi te rruges punuese.	copë	1.0	50.00 €	50.00 €
2.1.17	Blerja, bartja, futja paraprake ne gypa te brinjezuar dhe shtrirja ne kanale e te gjitha kabllorve te te gjitha rrjeteve telekomunikuese ajrore qe aktualisht ndodhen në rrugen afër Stacioni Autobusave. Per tu perfunduar me sukses kjo punë eshte i domosdoshem konsultimi me PTK-n dhe pronaret tjerë te rrjeteve telekomunikuese qe ndodhen ne rrugen qe po e trajtojmë me qellim qe të caktohet sakt lloji i kabllave telekomunikuese qe do te vendosen neper kanale. Qmimi duhet te ipet si i tërë pasi qe nuk dihet sakt lloji i kabllave dhe gjatsia e tyre.	komplet	1.0	50.00 €	50.00 €
2.1.18	Blerja, bartja, shtrirja ne kanale dhe lidhja e te gjitha kabllorve te te gjitha rrjeteve telekomunikuese ajrore nga tabelat telekomunikuese e deri te shfrytzesit aktual te ketyre sistemeve. Per tu perfunduar me sukses kjo punë eshte i domosdoshem konsultimi me PTK-n dhe pronaret tjerë te rrjeteve telekomunikuese qe ndodhen ne rrugen qe po e trajtojmë. Qmimi duhet te ipet si i tërë dhe duhet te mbuloj te gjitha shpenzimet shtesë ne rastë te paraqitjes se problemeve pronsore gjate kalimit te kabllave neper disa prona	komplet	1.0	50.00 €	50.00 €
2.1.19	Matja , shqyrtimi dhe testimi i rrjetit elektrik , marrjen e pelqeimeve nga KEDS	komplet	1.0	50.00 €	50.00 €
Gjithsej: Pos E2				3,010.00 €	
E. REKAPITULIMI - INSTALIMET ELEKTRIKE TË STACIONIT AUTOBUSAVE					
E1	PUNËT NDËRTIMORE	Gjithsej: Pos E1		948.00 €	
E2	PUNËT E INSTALIMEVE ELEKTRIKE	Gjithsej: Pos E2		3,010.00 €	
TOTALI ME TVSH				3,958.00 €	
F	PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR NDËRTIMIN E TROTUARVE				
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
1.1	Mobilizimi dhe rregullimi i punishtes për punë si dhe largimi i instalimeve ne punishte në rast se ka në ato hapësira.	m'	80.00	0.50	40.00 €

1.2	Shenimi i trasesë si dhe përcjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit.	m'	80.00	0.20	16.00
1.3	Pastrimi i trasesë rrugës nga të gjitha materialet që pengojnë pregaditjen e plenumit. Në qmim të kalkulohen të gjitha materialet e panevojshme komplet për gjatësi të rrugëve.	m'	80.00	0.30	24.00

Gjithsej 1.0: **80.00**

2.0	PUNIMET E DHEUT				
2.1	Germimi i tamponit t=10 cm me mundësi që i njëjti prap të përdoret.	m ³	11.44	3.00	34.32
2.2	Gërmimi i dheut me makineri të kategorisë së IV-V të me ngarkim dhe bartje deri në deponi (deri në 15Km). Sasia të llogaritet në gjendje natyrale.	m ³	68.64	2.00	137.28
2.3	Formësimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të rrugës me ngjeshmeri 40MN/m ² .	m ²	114.40	1.00	114.40

Gjithsej 2.0: **286.00**

3.0	MBISTRUKTURA				
3.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i tamponit (80MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm me trashësi t=25cm, si dhe ngjeshja me cilindër 25t.	m ³	26.00	5.00	130.00
3.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i tamponit (100MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=15cm, si dhe ngjeshja me cilindër 25t.	m ³	15.60	6.00	93.60
3.3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e skajoreve në bazament betoni, C-35/37, me dim. 15x22x100cm	m'	80.00	4.50	360.00
3.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e kubzave të betoni t=8cm, C-35/37 në shtresë rëre frak. (4-8)mm me t=5cm dhe mbushja e fugave me rër, duke përfshirë edhe zgjerimet dhe kyqjet në rrugë.	m ²	104.00	7.00	728.00
3.5	Ngjitja dhe nivelizimi i pusetave të kanalizimit ekzistues deri në nivelin e kubzave, si dhe furnizimi me kapk metalik 25t dhe montimi i tyre në bazament betoni.	copë	3.00	25.00	75.00
3.6	Rregullimi i trasesë dhe pastrimi i punishtës nga materialet ndërtimore.	m'	80.00	0.30	24.00
			Gjithsejt 3.0:		1,410.60

REKAPITULLIMI I NDËRTIMIT TROTUARVE

1.0	PUNËT PARAPRAKE	Gjithsej 1.0:	80.00
2.0	PUNIMET E DHEUT	Gjithsej 2.0:	286.00
3.0	MBISTRUKTURA	Gjithsejt 3.0:	1,410.60
		Gjithësejt POS F1	1,776.60

I					
PUNËT E TJERA					
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
1	Furnizimi, transporti dhe montimi i kontinierit me kabinë me shikim 360shkallë për monitorim të hyrjeve dhe daljeve të autobusave , me ndriqim , përfshirë sistemin e klimatizimit dhe ventillimi si dhe pajisjet tjera përcjellëse, kompjuterit për regjistrim hyrje dalje të autobusave , tavolinë , karrike si dhe panelin komandues për ngritje dhe zbritje të laurave (Rampave) në portat hyrëse dhe dalje. Në qmim llogaritet edhe platforma e bazamentit ku përforcohet kontinieri Llog komplet.	Komplet	1.00	150.00 €	150.00 €
2	Furnizimi, transporti dhe montimi i ramapave (Laurat) , si bashku me elementet përcjellëse , me mekanizëm për ngritje dhe ulje të ramapve në portat hyrëse dhe dalje.Nëqimim kalkulohet instalimet elektrike dhe telekomunikuese për dirigjim të ngritjes dhe uljes së ramapave nga kabina monitoruese. Llog komplet me të gjitha shpenzimet për funksionalizimin e këtij projekti.Rampat duhet të jenë me sinjalizimin fluroshentë për ndriqimin natë me qëllim që të jenë të dukshme natën dhe të mbrohen nga demtimin eventual. Llog komplet	Komplet	2.00	900.00 €	1,800.00 €
3	Furnizimi, transporti ,suvatimi dhe ngjyrosja e murit ekzistues nga pjesa mbrapa e stacionit autobusave me llaq betonit , dhe ngjyrës akrilike për beton në dy shtresa . Nuancën e ngjyrës përcakton investitori. Llog në m2	m2	300.00	1.20 €	360.00 €
Gjithsej: Pos II					2,310.00

REKAPITULLIMI I FINAL			
1	PUNËT PËRGADITORE	Gjithsej: Pos 1	376.10
2	PUNËT E DEMOLIMI	Gjithsej: Pos 2	1,050.00
A	OBJEKTI I TUALETEVE	Gjithsej: Pos A	22,527.12
B	PJESA E JASHTME E STACIONIT	Gjithsej: Pos B	30,651.50
D	TRAJTIMI UJËRAVE NË PLLATON E STACIONIT AUTOBUSAVE	Gjithsej: Pos D	4,939.12
E	INSTALIMET ELEKTRIKE NË PLLATON E STACIONIT AUTOBUSAVE	Gjithsej: Pos E	3,958.00
F	PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR NDËRTIMIN E TROTUARVE	Gjithsej: Pos F	1,776.60
I	PUNËT E TJERA	Gjithsej: Pos I	2,310.00
TOTALI ME TVSH			67,588.44

1.3. Vlera Totale e Kontrates me TVSH dhe taksa tjera eshte 67.588.44€

(Gjashtedhjetë shatemiye pesëqindetëdhjeteteteuroe 44/100)

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë i përditëshem sipas përshkrimit të detyrave nga neni 1 i kësaj kontrate eshte **120 dite KALENDARIK**.

2.2 Vendi i kryerjes së puneve sipas Projektit Ish tregu i Gjellbert ne .Kline :

Neni 3

Çmimi

3.1 Çmimet njësi të puneve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 1.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kryesit të punimeve sipas kontratës publike.

3.3 Çmimet e njësisve do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

3.5. Dhe atë me fature dhe Raport mbi kryerje të puneve, Jo më larg se 30 dite pas pranimit të fatures dhe Raportit.

Neni 4

Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3. Pagesat do të ekzekutohen me keste sipas dinamike së kryerjeve të punimeve
Pagesat do të behen sipas situacineve mbi kryerje të punimeve me Raport nga Komisioni dhe Fatura. Jo më tepër se 30 dite pas pranimit të fatures dhe Raportit.

- Kesti –perfundimtare në vlerë 6.758.84 €, pas afati të Garancionit të punimeve, perkatesisht pas 12 muajeve .Apo me garancion nga Banka perkatesisht Kompani sigurimeve.

Neni 5

Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6

Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

6.2. Kryesi i puneve do te jete pergjegjes per Demtimet te shkaktuara me dashje apo pa kujdesi ne masen e demit qe do te percaktohet nga zyrtari pergjegjes .

Neni 7 Vonesat në ekzekutim

7.1 Ne raste deshtimit apo voneses ne Implementim , Do te penalizohet me masen 0.25% ne dite vonese nga vlera totale e kontrates.

Neni 8 Inspektimi dhe testimi

8.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, dhe të shikoj furnizimet e bera nese eshte ne masen e cilesive te kerkuara .

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

10.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 5 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 11 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

11.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

11.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën themelore _dega Kline në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 12 Komunikimi

12.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë

12.2 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


Neni 6. Menaxhimi i projektit dhe menaxhimi i kontratës .

6.1. Menxhimi i projektit do te behet nga njesia kërkuese –Implementuese Drejtoria Urbanizmit Komuna Kline

6.2 .Menxhimi i Kontrates . Bazuar ne neni 81 te LPP , Menaxhi i kontrtaes me vendim te ZKA do te jete : _____ nga

6.3 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në kater origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues KOMUNA KLINE

Emri:	ABAZ FONIQI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	19.01.2021
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve : SHALA BUILDING SHPK – KLINE

Emri:	VETON SHALA
Pozita:	PRONAR
Nënshkrimi:	 19.01.2021
Data:	
Vula:	



PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuoruar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 "Ofrues i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shumën e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rast, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj të një palë të tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktuar pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshatshmerisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundojë aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospective dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forcë Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objekteve ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paafësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmëroj palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e parapare në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës; (i) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që pengon realizimin e kontratës; (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të leshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

